



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

KOMISIONI I ZGJEDHJEVE I FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA

V E N D I M

Nr. 01 datë 12.05.2024

Për hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për "Drejtues/Dekan të njësisë kryesore" dhe për "Drejtues të njësisë bazë" në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në kuadër të procesit të zgjedhjeve të përgjithshme për autoritetet dhe organet drejtuese të Universitetit të Tiranës.

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në UT", nr. 5, datë 10.02.2020, kreu I, neni 5 si dhe neni 7, pika 7, gërma d), dhe të Urdhrit të Rektorit të UT-së, nr. 2, datë 21.3.2024 "Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese dhe Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës", në mbledhjen e datës 12.05.2024, Komisioni i zgjedhjeve i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja i UT-së

V E N D O S I

1. Të shpallë hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për "Drejtues/Dekan të njësisë kryesore" dhe për "Drejtues të Njësisë bazë" në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës.
2. Kandidatët mund të regjistrohen në datat 13, 14, 15, 16 dhe 17 maj 2024, pranë Sekretarisë së KZFGJH-së (Godina B, auditori 106), ose elektronikisht, në adresën kzffgjhut@unitir.edu.al, nga ora 09.00-16.00, sipas Formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I ZGJEDHJEVE TË FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA:

- | | |
|---------------------|-----------|
| 1. Anida Kisi | (Kryetar) |
| 2. Kristina Sheperi | (Anëtar) |
| 3. Andia Dani | (Anëtar) |
| 4. Manjola Nasi | (Anëtar) |
| 5. Elda Katorri | (Anëtar) |
| 6. Marisa Janku | (Anëtar) |
| 7. Eda Shehu | (Anëtar) |
| 8. Edlira Jorgaqi | (Anëtar) |
| 9. Katerina Çepe | (Anëtar) |

Adresa: Rruga "Elbasanit", Tiranë, email: info.fgjh@unitir.edu.al, www.fgjh.edu.al